



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234043
Datë: 18.12.2023
Numri i dokumentit: 05081523

C-IV-14-2354

Ankuesi

B K, Prizren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRZ017-0004/0025 datë 10 mars 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **B K** në emër të kërkesës për kompensim për pagat e pa paguara për periudhën prej 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, t’i paguaj **shumën prej 4,689.62 €**, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pabazuar.
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 04 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRZ017-0004/0025 i datës 10 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për pagat e pa paguara për periudhën prej 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 në shumë bruto prej 10,621.00 €, nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” në likuidim. Ankuesi pohoi se pasi që NSH “Ramiz Sadiku” në Prizren në vitin 2006 është privatizuar dhe më vonë me vendim të bordit të AKP-së datë 15 maj 2006 është futur në proces të likuidimit, ai së bashku me punëtorët e tjerë, pas privatizimit nga AKM-ja ka marr njoftimin

për ndërprerje të marrëdhënies së punës ku është udhëzuar që kur kjo ndërmarrje hynë në likuidim, mund të parashtrijë kërkesë për kompensimin e pagave të papaguara tek kjo agjenci. Të gjithë punëtorët duke vepruar sipas këtij udhëzimi e kanë parashtruar kërkesën kolektive për kompensimin e pjesës së pagave të papaguara për periudhën 01 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005, në përputhje me nenin 40.1.7 të aneksit të Ligjit për AKP-në nr.04/L-034. Ankuesi theksoi se AL me vendimin e saj nuk e ka kontestuar ligjshmërinë e kërkesës si dhe shumën e kërkuar, por të njëjtën e ka refuzuar si kërkesë e parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar duke cekur se pagat në fjalë janë parashkruar në përputhje me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (nr.53 të vitit 1976) dhe se nuk ka prova se ankuesi ka kërkuar mbrojtjen gjyqësore brenda 3 viteve nga momenti kur NSH supozohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj monetare ndaj ankuesit konkretisht më së voni deri 01 korrik 2002. Ankuesi më tej pohoi se arsyetimi për refuzimin e kërkesës fare nuk përputhet me realitetin e as me ligjin, për arsye se AKM-ja e atëhershme vet kishte udhëzuar punëtorët se kompensimi i pagave të papaguara do të bëhet kur të filloj procesi i likuidimit dhe se atëherë duhet paraqitur kërkesën tek komiteti i likuidimit të AKM-së. Duke vepruar sipas këtij udhëzimi të AKM-së punëtorët kanë pritur që të filloj procesi i likuidimit (15 maj 2006) dhe se kur ka ndodhur kjo ata menjëherë më 01 gusht 2006 e kanë parashtruar këtë kërkesë në AKM dhe se tani thuhet se pagat janë vjetërsuar për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar, është tepër joserioz dhe paraqet një lloj mashtrimi nga kjo agjenci. Ankuesi më tej pohoi se çështja e datave ka qenë kompetencë e AKM dhe ajo vet e ka përcaktuar datën e privatizimit dhe se i ka informuar punëtorët se për çfarëdo page të papaguar punëtori duhet të parashtrijë kërkesë tek AL. Sa i përket parashkrimit me paraqitjen e kërkesës me datë 01 gusht 2006 në AKM është ndërprerë afati i parashkrimit në përputhje me nenin 388 të LMD(nr.29/1978). Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovoj kërkesën e tij si të bazuar në ligj sipas nenit 40.1.7 të aneksit të Ligjit për AKP-në nr.04/L-034. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar, Formularin e kërkesës kolektive në likuidim dorëzuar me 01 gusht 2006 dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit drejtuar ankuesit lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 21 shkurt 2006.

Me 17 mars 2020, e paditura parashtrioi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Neni 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. Ankuesi në fjalë nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 35.2.4 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që një *“ankesë duhet të përmbajë...argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa”*. Në vend të argumenteve ligjore, ankuesi thjeshtë ka deklaruar se ai nuk pajtohet me vendimin. E paditura më tej theksoi se përveç se ankesa është e dorëzuar me vonesë, çfarë e bën të papranueshme atë, pretendimet e ankuesit janë të parashkruara pasi ankuesi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik kundër NSH-së gjatë periudhës 1 korrik 1999-1 korrik 2002 (afati tre vjeçar

i parashkrimit). Këtë qëndrim e ka mbajtur edhe gjykata përmes aktgjykimit C-IV-13-2611 datë 14 qershor 2016, C-IV-13-2514 datë 13 maj 2016 si dhe aktgjykimit C-IV-0532 datë 09 gusht 2016 trajtimi i AL është konsideruar i drejtë në lidhje me zbatimin e parashkrimit tre vjeçar. Po ashtu kolegji i ankesave i DHPGJS tashmë e ka afirmuar njohjen e drejtë të zbatimit të Nenit 608 të LPB në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, përmes aktgjykimit me nr. AC-I-15-0253 datë 27 shtator 2016. Pra, kërkesa e ankuesit është parashkruar në pajtim me Nenin 36.2.1 dhe 37.4.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. AL dhe DHPGJS nuk mund të nxjerrin një vendim që NSH i ka mbetur borxh paga të papaguara ankuesit apo që NSH nuk i ka mbetur borxh atë shumë ankuesit. Njoftimi i datës 21 shkurt 2006 i lëshuar nga AKM nuk mund të konsiderohet asnjëherë si pranimit i borxhit duke qenë se nuk përmban asnjë element për tu cilësuar si i tillë. Vlen të theksohet se letra në fjalë është një shabllon që u dërgohet mijëra punëtorëve pa kurrfarë konsiderate për borxhet konkrete që NSH-ja mund ti kishte atyre – por bazuar në faktin e vetëm që emrat dhe adresat e këtyre punëtorëve kanë figuruar në arkivin e NSH-së. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.06/L-086. Në mbështetje të mbrojtjes së saj e paditura ka bashkangjitur në kopje Vendimin për Emërimin e Anëtarëve të AL datë 30 shtator 2016.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashih se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parashih se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”* .

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRZ017-0004/0025 i datës 10 mars 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme (e parashkruar) kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara për periudhën prej 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 në shumë bruto prej 10,621.00 €, nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” (në likuidim).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “NIN Ramiz Sadiku”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borgj pagat për periudhën 01 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se kërkesa e ankuesit për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesi pretendon se kërkesa e tij është e ligjshme dhe e njëjta nuk është e parashkruar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit drejtuar ankuesit lëshuar nga AKM datë 21 shkurt 2006, Formularin e kërkesës kolektive në likuidim dorëzuar me 01 gusht 2006 së bashku me Listën e pagave të papaguara për periudhën objekt kontesti (fakt mbështetës në formularin e kërkesës), si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga, njoftimi për përfundimin e punësimit, i datës 21 shkurt 2006, i dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “NIN Ramiz Sadiku” deri me 21 shkurt 2006, kohë edhe kur shumica (apo të gjitha) asetet e NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar.

Nga lista e pagave të papaguara për periudhën 1 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005 (e cila ishte dorëzuar tek AL dhe nuk kontestohet nga e paditura) vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar dhe se NSH-ja i kishte mbetur borgj ankuesit pagat e papaguara për periudhën objekt kontesti dhe atë të gjitha këto në shumë totale prej 10,621.00 €.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, Njoftimin për përfundimin e punësimit, lëshuar me 21 shkurt 2006 nga AKM dhe Formularin e kërkesës kolektive në likuidim dorëzuar me 01 gusht 2006 së bashku me Listën e pagave të papaguara për periudhën objekt kontesti (fakt mbështetës në formularin e kërkesës), për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borgj pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borgj pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as

lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e tij.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 4,689.62, gjykata i njeh ankuesit 34 paga të papaguara nga gjithsejtë 77 paga mujore të kërkuara për periudhën objekt kontesti. Shumën e përgjithshme të kërkuar nga ankuesi prej 10,621.00 €, gjykata e ka pjesëtuar me 77 paga të papaguara dhe ka nxjerr mesataren e pagës mujore të ankuesit në shumë prej 137.93 € (apo 34 paga x 137.93 € = 4,689.62 €). Gjukata ia njeh ankuesit pagat mujore të papaguara nga muaji shkurt 2003 e deri në dhjetor të vitit 2005, meqë ato nuk janë parashkruar, ndërsa pagat e papaguara nga 01 korriku 1999 deri në janar të vitit 2003, refuzohen për shkak të parashkrimit.

Gjukata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë (sipas kërkesës kolektive) brenda afateve tek AL me 1 gusht 2006. Gjukata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 21 shkurt 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar në tërësi nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Andaj, gjykata vie në përfundim se ankuesi kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borgj pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar

.